



Data: 12.06.2018

Ref.: 618/MBD

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë: 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 53-të, të mbajtur më 22 Shtator 2017, mori:

V E N D I M

1. Përmirësohet vendimi i KSHC-së, Ref.: 488/18 D, datë: 18.05.2018, i Kolegjit ISPE.
2. Përmirësohet emërtimi i institucionit nga: Kolegji "Iliria" në Kolegjit "ISPE", aty ku emërtimi i këtij institucioni është shënuar gabim si rezultat i një lëshimi teknik.
3. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së me Ref.: 488/18 D, datë: 18.05.2018, mbetet e pandryshuar.

A r s y e t i m i

Në vendimin Ref: 488/18 D, datë: 18.05.2018, në pjesët ku referohej institucioni ishte cekur katër herë Kolegji "ISPE", ndërsa ishte lëshuar një gabim teknik dhe një herë në vend të Kolegjit "ISPE" ishte shënuar Kolegji "Iliria". Pas njoftimit nga Kolegji "ISPE" për një lëshim teknik në vendimin e lëshuar nga AKA, me qëllim të korrigjimit të këtij lëshimi teknik, AKA lëshon këtë vendim.

Duke pasur parasysh arsyet e cekura më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendim.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 131, të Ligjit mbi Procedurën Administrative Nr. 05/L-031. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit "ISPE"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

